



In medias res

## **Çfarë duhet të ndryshojë në arsimin e Kosovës (1)?**

Në sistemin e arsimit, për shkak të trashëgimisë, së pavolitshme, gjendjes nëpër të cilën ka kaluar Kosova, gjendjes së tashme të tranzicionit dhe të funksionimit të disa sistemeve juridike, jo gjithnjë koherente dhe të harmonizuara, duhet të pësoj ndryshime të plota në të gjitha nivelet dhe në të gjitha elementet strukturale të tij.

Objekt ndryshimi duhet të jenë:

- Nën sistemi i qeverisjes, udhëheqjes dhe i menaxhimit, sepse në studimet e shumta meta-analitike katërçipërisht është konstatuar se askund nuk është gjetur një lidhje korrelative pozitive ndërmjet lidhshimit të dobët dhe të efektivitetit të lartë të sistemit ( Grey dhe të tjerë). Lidhur me këtë John Maxvell thotë: “E ndërruar udhëheqësin, e keni ndërruar organizatën...Ndryshimi do të thotë zhvillim”
- Duhet të ndërrohet infrastruktura ligjore me qëllim që nëpërmjet decentralizimit, rritjes së autonomisë së organizatave edukative dhe arsimore të rritet përgjegjësia dhe llogaridhënia në të gjitha nivelet e sistemit të arsimit.
- Duhet të ndërroj struktura e tashme e sistemit të arsimit sepse kjo strukturë nuk është koherente, nuk është e zhvilluar në mënyrë të barabartë, kalimi nga një nivel në nivelin tjetër të sistemit është stresiv i panatyrshëm, jo mbështetës, në aspektin juridik me vështirësi praktike të zbatimit.
- Monitorimet dhe vlerësimet janë pikë e dobët e sistemit të tashëm të arsimit, duhet krijuar sistem të fuqishëm të monitorimit dhe të vlerësimit në funksionim të përparimit në karrierë për të gjitha nivelet.
- Duhet hartohet një nënstrategji zhvillimore për zhvillimin e edukimit parashkollor me qëllim të përfshirjes së plotë të të gjithë fëmijëve parashkollor të moshës 3-6 vjeçare në edukimin parashkollor të organizuar.
- Duhet të rishikohet struktura e tashme e arsimit të detyruar, sepse sistemi i tanishëm jo vetëm që nuk është në përputhje me zhvillimin psikik dhe fizik e fiziologjik të fëmijëve, por është stresiv dhe shumë jopraktik për kushtet dhe specifikat konkrete kosovare. Kjo strukturë (me jokomplementaritetin natyror, juridik, pedagogjik dhe psikologjik) ka ndikim të drejtpërdrejtë negativ në organizim, në efikasitet, në efektivitet, në shndërrimin Kosovës në një shtëpi të madhe të të nxënësve. Ndryshimet duhet të ndodhin në strukturë, në planifikim, infrastrukturë, në fushën e standardeve të përmbajtjes, të arritjeve, të pajimeve, mjeteve mësimore, të objekteve mësimore, në fushën e sigurisë, të mjedisit të përshtatshëm të të nxënësve etj.
- Në arsimin e mesëm duhet të bëhen ndryshime thelbësore. Duhet të shikohen tipat e gjimnazit me tendencë që të mos ketë me shume se 2-3 tipa të gjimnazeve. Lëndët mësimore duhet të reduktohen në më së shumti deri në shatë lëndë mësimore. Duhet të hartohen standardet e avancuara të përmbajtjeve, të arritjes, të pajimeve, të mjeteve dhe të objekteve mësimore. Duhet të përcaktohen kriteret për regjistrim në këto gjimnaze që do të jenë të standardeve të larta.

Vazhdon!

*Shkroi: Halim Hyseni*

## **Mendimi Kritik gjatë Leximit dhe Shkrimit – MKLSH**

■ Më 26-27 shtator është mbajtur seminari i katërt “Teknika të tjera për zhvillimin e mendimit kritik” për 43 mësues të shkollave fillore dhe të mesme të Komunës së Obiliqit. Nga raportimet e trajnerëve kuptohet se mësuesit e pëlqejnë shumë programin e trajnimit, sepse kanë vërejtur përmirësim në angazhim e nxënësve me rastin e zbatimit të këtyre teknikave në klasat e tyre. Me përfundimin seminarit të katërt, trajnerët kanë filluar monitorimin e mësuesve në klasat e tyre. Monitorimi do të vazhdojë deri më 9 tetor 2009. Ky trajnim organizohet në bashkëpunim me Drejtoratin Komunal të Arsimit në Obiliq.

## **Monitorimi i menaxhimit të financave komunale të arsimit në 5 komuna të Kosovës**

■ Më 1 shtator 2009, KEC ka filluar implementimin e projektit “Monitorimi i menaxhimit të financave komunale të arsimit në 5 komuna të Kosovës”. Ky projekt është mbështetur nga Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur (KFOS) dhe ka për synim sigurimin e një shkalle të lartë të transparencës në menaxhimin e financave në nivelin komunal të arsimit. Në kuadër të projektit, më 25 shtator është mbajtur një punëtori në të cilën janë identifikuar fushat e monitorimit, treguesit e monitorimit, si dhe instrumentet për monitorim. Rezultatet e kësaj punëtorie kanë shërbyer në përpilimin e kornizës për monitorim që do të shfrytëzohet nga monitorët vendorë.

## **Krijimi i mjediseve të sigurta, jo të dhunshme dhe humane në shoqëri dhe shkolla**

■ Gjatë muajit shtator janë mbajtur pesë punëtori njëditore me aktivet e drejtorëve të komunave pilot të këtij projekti, pra në Prizren, Gjakovë, Mitrovicë, Pejë dhe Gjiilan.



■ Është punuar mjaft shumë në përgatitjen e disa materialeve konkrete që lidhen me zbatimin e projektit: Plani i veprimit për Zbatimin e Projektit të mjediseve të sigurta, jo të dhunshme dhe humane/miqësore në shkolla dhe në shoqëri; Modeli orientues i planit të veprimit të Drejtorit të shkollës; Rregullorja për përdorimin e Kutisë për të Drejtat e Fëmijës.



■ Gjatë kësaj periudhe është bërë monitorimi inicial në 13 shkolla fillore të Komunës së Prizrenit

## **Hap pas Hapi**

■ Në Gjakovë me iniciativën e mësuesve që këtë vit punojnë me klasat e

para, u iniciua trajnimi fillestar për klasën e parë. Trajnimi u mbajt me datat 5,6 dhe 12,13,14 shtator dhe morën pjesë 32 pjesëmarrës. Ky grup me qëllim të certifikimit, ka vendosur që prezantimet e planeve ditore t'i mbaj më 13 shtator.

### **Ngritja e cilësisë në edukimin e fëmijërisë së hershme**

■ Në kuadër të këtij projekti do të zhvillohen trajnime për monitorimin e mësimdhënësve. Këto trajnime i dedikohen drejtorëve, zëvendësdrejtorëve, pedagogëve të shkollave fillore dhe institucioneve parashkollore, si dhe zyrtarëve të arsimit. Qëllimi i trajnimit është që të përcillet në mënyrë sistematike puna e mësimdhënësit, me qëllim të mbajtjes së një sistemi të organizuar të monitorimit brenda shkollës apo institucionit parashkollor.

■ Paraprakisht një grup prej 10 ekspertësh kanë hartuar "Instrumentet e monitorimit të mësimdhënësve", të cilat janë edhe bazë e trajnimit. Pas trajnimit të gjithë pjesëmarrësit kanë mundësi të praktikojnë monitorimin në praktikë. Kjo organizohet ashtu që secili grup dy herë organizon monitorimin në një shollë, herën e parë në çifte, herën e dytë nga 6 veta së bashku. Mbas përfundimit të monitorimit në praktikë çdo herë parashihet një punëtori ku pjesëmarrësit diskutojnë rreth përvojës që patën gjatë monitorimit,

■ Gjatë muajve gusht dhe shtator janë organizuar 6 trajnimet për monitorimin e mësimdhënësve ku pjesëmarrës kanë qenë drejtorë e shkollave fillore:

Prishtina	21, 22, 23 gusht
Peja	30 gusht, 1, 2 shtator,
Gjakova	11,12,13, shtator
Prizreni	11,12,13, shtator

Skenderaj	16,17,18 shtator
Ferizaj	25, 26,27 shtator

■ Drejtorët e shkollave fillore, drejtorët e institucioneve parashkollore, zyrtarët dhe inspektorët nga Drejtoritë Komunale të Arsimit dhe Sektorët për Inspektimit të Arsimit të Mitrovicës, dhe Gjilanit do të marrin pjesë në trajnimet e parapara gjatë muajit tetor.

### **KOSOVISION Contest**

■ Gjatë këtij muaji filluan aktivitetet për vitin e dytë të këtij projekti. Pas nënshkrimit të kontratës me donatorët e projektit, janë mbajtur takime në të gjitha Komunitatet e Kosovës, ku janë ftuar të gjithë drejtorët e shkollave fillore për tu njohur më gjerësisht me projektin KOSOVISION CONTEST 2.



■ Pas organizimit të takimeve me drejtorë, në kuadër të këtij projekti janë organizuar edhe 60 punëtori me mësimdhënësit e klasave të pesta, pra, me mësimdhënësit që do të jenë pjesëmarrës të projektit në këtë vit shkollor. Punëtoritë me mësimdhënës kanë shkuar mjaft mirë. Mësimdhënësit po ashtu janë pajisur edhe me mjetet të cilat do ti përdorin për realizimin e këtij projekti.



- Që nga data 22 shtator, të gjitha klasat e pesta kanë filluar me orën e parë të punës së tyre në projektin KOSOVISION CONTEST 2.

### **Promovimi i të drejtave të fëmijës në fushën e arsimit**

- Në kuadër të këtij projekti të financuar nga Zyra Ndërlidhëse e Komisionit Evropian në Kosovë, janë organizuar disa aktivitete. Në fillim të muajit është organizuar një punëtori njëditore si vazhdim i punëtorisë së mëhershme. Në këtë punëtori u bë finalizimi i kornizës së monitorimit. Ky dokument është dërguar të përkthehet në gjuhët zyrtare të Kosovës.



- Po ashtu këtë muaj është mbajtur edhe takimi i Këshillit Drejtues të

projektit të cilët diskutuan për arritjet e bëra në projekt gjatë periudhës gjashtë mujore.

- Këtë muaj janë organizuar trajnimet për monitoruesit e brendshëm dhe ata të jashtëm të shkollave të cilat janë pjesëmarrëse në projekt. Ky trajnim është organizuar në Rajonin e Prizrenit ndërsa në Prishtinë do të organizohet në fillim të muajit tetor. Monitoruesit, në këtë trajnim janë pajisur me materialet e nevojshme të punës, si dhe kanë bërë ndarjen e detyrave, respektivisht ndarjen e shkollave të cilët ata do ta monitorojnë.

### **Avancimi i pjesëmarrjes dhe përfaqësimit të grupeve të pakicave etnike në arsim**

Gjatë muajit shtator në kuadër të projektit “Avancimi i pjesëmarrjes dhe përfaqësimit të grupeve të pakicave etnike në arsim” të financuar nga Komisioni Evropian janë zhvilluar këto aktivitete:


- Më 1 dhe 2 u mbajt takimi i parë i hulumtuesve në kuadër të komponentës 2 të Projektit “Hulumtimet Kombëtare”. Në takim morën pjesë hulumtues nga Kosova, Shqipëria, Serbia, Bosnja dhe Hercegovina, dhe Kroacia, si dhe dy përfaqësues nga Rumania dhe një nga Britania e Madhe në cilësinë e ekspertëve nga Bashkësia Evropiane. Takimi ishte shumë frytdhënës, u diskutuan shumë detaje në lidhje me hulumtimet që do të bëhen në secilin shtet pjesëmarrës në projekt. U hartua edhe plani i aktiviteteve deri në përfundim të komponentës 2 të projektit.



■ Sa i përket komponentës 3 të projektit “Praktikat më të mira” shtetet pjesëmarrëse në projekt janë duke i emëruar ekipet kombëtare të cilat do të punojnë për mbledhjen e praktikave më të mira sa i përket përfaqësimit dhe pjesëmarrjes së pakicave në arsim.

## Prevention on Peer Violence

■ Pjesa e dytë e trajnimit për trajnerë në kuadër të këtij projekti, është mbajtur nga data 25-27 shtator 2009. Trajnimi është mbajtur në Prevallë dhe pjesëmarrës ishin 40 persona. Në trajnim janë zhvilluar temat për dhunën ndaj bashkëmoshatarëve dhe janë trajtuar edhe tema tjera për parandalimin e kësaj dukurie. Duke ditur se në trajnim kanë qenë të ftuar edhe psikologët të cilët janë pjesë e këtij projekti, ata ndihmuan pjesëmarrësit që të identifikojnë këto çështje në shkollat e tyre ku ata punojnë.



■ Pasi që materialet do të jenë gati për punëtoritë nëpër shkolla, atëherë do të filloj edhe trajnimi i mësimitdhënësve e më vonë edhe trajnimi i nxënësve për këtë temë.

Psikologët kanë bërë ndarjen e shkollave ku ata do të jenë prezent sa herë që shkollat kanë nevojë, e po ashtu edhe do të ju ndihmojnë pjesëmarrësve të

trajnimit të mbajnë punëtoritë në këto shkolla.



■ Pas përfundimit të këtyre dy trajnimeve, pjesëmarrësit u certifikuan si trajnerë të projektit “Parandalimi i dhunës ndaj bashkëmoshatarëve”, me gjithsej 48 orë trajnimi”.

## Avancimi i komunikimit me prindër në shkollat e Kosovës

■ Gjatë shtatorit në kuadër të projektit “Avancimi i komunikimit me prindër në shkollat e Kosovës” janë mbajtur prezantime para mësimitdhënësve të 4 shkollave të Kosovës për metodologjinë dhe procedurat e zhvilluara nga grupi punues për avancimin e komunikimit me prindër. Ka mbetur të mbahet edhe prezantimi para mësimitdhënësve të shkollës “Hilmi Rakovica” në Prishtinë, si dhe të vazhdohet me hapin tjetër që është monitorimi gjatë takimeve individuale me prindër.

## Access Microscholarship Program

■ Më 29 shtator, respektivisht 30 shtator filloi mësimi për të dy grupet e Access Microscholarship Program në

---

Prishtinë. Paraprakisht u mbajt një aktivitet social më 19 shtator, ku u ftuan fëmijët e të dy grupeve së bashku. Amy Schrimmer dhe Jehona Shala mbajtën aktivitete të ndryshme me fëmijë. Vlen të theksohet se fëmijët ishin shumë të kënaqur dhe të hapur në lojë. Ky aktivitet u shfrytëzua që të caktohet orari i ri i Access, pasi që shumicës së fëmijëve u është ndërruar orari i orëve të mësimi në shkollë. Në fund u arrit konsensusi që fëmijët ti vijojnë orët e Access pasdite prej orës 18:00 deri 19:30.

■ Grupi i Prizrenit ende nuk i ka filluar orët e Access në mungesë të profesorit i cili do ti mbante orët. Është duke u punuar në këtë drejtim, për gjetjen e një profesori.

*Përgatiti: Petrit Tahiri*